ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E KULTURËS DHE TURIZMIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **207-26-5961-5-1-1**

Sa i përket tenderit për ***Revitalizimi i Kino Teatrit Jusuf Gervalla - Pejë***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

IDEAL PARTNERS "SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

"Rr. Fehmi dhe Xheve Lladrovci,Drenas
(Adresa)

Drenas, Kosovë — *(Vendi)*

13 000 — *(Kodi postar)*

+38349241819 — *(Numri Telefonit)*

N/A — *(Numri i Faks-it)*

Kushtrim Berisha
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

idealpartnersshpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

02.11.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi per kontrate 22.07.2026 13:47 Dosja e tenderit 22.07.2026 Korrigjimi i dosjes se tenderit : 28.08.2026 Vendimi i AK - 02.10.2026 14:31 Kerkese per qasje.pdf 02.10.2026 15:02 Kerkes per Rishqyrtim: 06.10.2026 Vendimi I Kerkeses per Rishqyrtim: 21.10.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 **Neni 1; i LPP-se, Qëllimi** **Neni 6** Ekonomiciteti dhe Efikasiteti **Neni 7: i LPP-se, Barazia në trajtim /Jo Diskriminimi** **Neni 10: i LPP-se, Mjetet e promovimit te transparences** **Neni 27: i LPP-se, Dosja e tenderit** **Neni 32: i LPP-se, Rregullat e përgjithshme** **Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik** **Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi I Rregullores për Prokurim Publik** **Neni 17 Dosja e Tenderit** **Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes** **Neni 27 Kriteret e dhënies së kontratës** **Neni 45 Procedur e hapur** **Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, dispozitat përkatëse të Neneve 65–70, kur ato ndërlidhen me përshtatshmërinë dhe kërkesat e kualifikimit** **Nenin 72, kur është relevant lidhur me dokumentacionin dhe sqarimet, si dhe Nenin 108/A – Kërkesa për Rishqyrtim, së bashku me dispozitat përkatëse të Rregullores për Prokurimin Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. BAZA LIGJORE

IDEAL PARTNERS SH.P.K., në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës dhe palës së interesuar në aktivitetin e lartcekur të prokurimit, në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, si dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik, paraqet këtë Kërkesë për Rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Kjo kërkesë mbështetet në veçanti në Nenin 1 të LPP-së – Qëllimi, Nenin 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Nenin 7 – Barazia në Trajtim/Jo-diskriminimi, Nenin 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, dispozitat përkatëse të Neneve 65–70, kur ato ndërlidhen me përshtatshmërinë dhe kërkesat e kualifikimit, Nenin 72, kur është relevant lidhur me dokumentacionin dhe sqarimet, si dhe Nenin 108/A – Kërkesa për Rishqyrtim, së bashku me dispozitat përkatëse të Rregullores për Prokurimin Publik, përfshirë dispozitat që rregullojnë procedurën e kërkesës për rishqyrtim.

II. ARSYETIMI I KËRKESËS

Të nderuar,

Autoriteti Kontraktues, përmes Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit "Revitalizimi i Kino Teatrit Jusuf Gërvalla – Pejë", ka shpallur IDEAL PARTNERS SH.P.K. operator ekonomik të pasuksesshëm dhe ka rekomanduar për dhënie të kontratës Grupin e Operatorëve Ekonomik TONI O.P.; N.N.P. ATC COM SH.P.K., me vlerë të ofertës 785,337.25 euro.

Pas shqyrtimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues, kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe dokumentacionit relevant të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, kemi konstatuar çështje dhe mospërputhje serioze faktike dhe juridike, të cilat do të paraqiten dhe argumentohen në mënyrë të detajuar në kuadër të pretendimeve ankimore dhe provave bashkëngjitur kësaj kërkese.

Konsiderojmë se këto gjetje kërkojnë rishqyrtim të plotë të procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, në mënyrë që të verifikohet nëse operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar realisht dhe në mënyrë të dokumentuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Në veçanti, Neni 7 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues që operatorët ekonomikë të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Për rrjedhojë, kërkesat e njëjta të Dosjes së Tenderit duhet të aplikohen dhe vlerësohen sipas të njëjtit standard ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, duke u mbështetur në Nenin 59 të LPP-së, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve duhet të realizohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara për aktivitetin e prokurimit. Prandaj, çdo devijim material nga kërkesat e detyrueshme të Dosjes së Tenderit duhet të trajtohet në përputhje me LPP-në dhe nuk mund të anashkalohet apo të trajtohet me standard tjetër vetëm për një operator ekonomik.

Në të njëjtën mënyrë, Nenet 1 dhe 6 të LPP-së vendosin parimet dhe detyrimet që lidhen me përdorimin transparent, të drejtë, ekonomik dhe efikas të fondeve publike. Vendimi për

dhënien e një kontrate publike duhet të jetë rezultat i një procedure të ligjshme dhe të një vlerësimi objektiv e të verifikueshëm.

Për më tepër, në rast se gjatë procedurës janë kërkuar sqarime apo dokumente plotësuese, kërkojmë të verifikohet zbatimi i Nenit 72 të LPP-së dhe dispozitave përkatëse të Rregullores për Prokurimin Publik, në mënyrë që procedura e sqarimit të mos ketë rezultuar në trajtim të pabarabartë apo në lejimin e ndryshimeve që tejkalojnë kufijtë e lejuar nga legjislacioni i prokurimit publik.

III. PRETENDIMET ANKIMORE DHE PROVAT

Në vijim të kësaj kërkese, IDEAL PARTNERS SH.P.K. do të paraqesë gjetjet konkrete dhe provat përkatëse, ku për secilin pretendim do të identifikohet:

kërkesa konkrete e Dosjes së Tenderit → dokumentacioni i operatorit të rekomanduar → mospërputhja e konstatuar → prova përkatëse → dispozita ligjore e shkelur → ndikimi i shkeljes në rezultatin e aktivitetit të prokurimit.

Të gjitha dokumentet, dëshmitë dhe materialet e bashkëngjitura duhet të konsiderohen pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj Kërkese për Rishqyrtim.

Pretendimi NR.1

Vërtetimi tatimor i operatorit ekonomik

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka paraqitur Vërtetim Tatimor të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës më 05.06.2026. Në vetë vërtetimin përcaktohet shprehimisht se vlefshmëria e tij është 90 ditë nga data e lëshimit. Vertetimet per tender (1).pdf

Hapja e ofertave është bërë më 02.09.2026, ndërsa vendimi për dhënie të kontratës është nxjerrë më 02.10.2026. Rrjedhimisht, në momentin e marrjes së vendimit për dhënie, vërtetimi tatimor i datës 05.06.2026 kishte kaluar periudhën 90-ditore të vlefshmërisë.

Për më tepër, vetë vërtetimi i ATK-së përcakton se informacionet e paraqitura janë të sakta dhe të plota në datën e lëshimit të vërtetimit, duke sqaruar njëkohësisht se vërtetimi nuk përjashton detyrimet tatimore që mund të lindin në të ardhmen. Vertetimet per tender (1).pdf Për këtë arsye, një dokument të cilit i ka përfunduar vlefshmëria nuk mund të shërbejë si dëshmi aktuale e gjendjes tatimore të operatorit ekonomik në fazën relevante para dhënies së kontratës.

Në këtë drejtim duhet të merret parasysh edhe praktika vendimmarrëse e OSHP-së, përfshirë Vendimin nr. 995/25, lidhur me detyrimin për verifikimin e dokumenteve të përshtatshmërisë së operatorit ekonomik në fazën para dhënies së kontratës.

Prandaj, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të verifikojë nëse operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka paraqitur, në fazën dhe brenda afatit të përcaktuar me Dosjen e Tenderit dhe legjislacionin në fuqi, vërtetim tatimor të vlefshëm. Nëse një vërtetim i tillë nuk është paraqitur në fazën kur është kërkuar, kërkojmë që kjo të trajtohet sipas pasojave juridike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe legjislacionin e prokurimit publik dhe të bëhet rivlerësimi i aktivitetit të prokurimit.

Pretendimi NR.2 – Casja ne Dokumente

Sipas Nenit 11 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik:

* Informacioni që duhet të bëhet publik gjatë hapjes së tenderit nuk mund të klasifikohet si

sekret afarist – Neni 11.2.
* Për informacione të tjera, duhet të plotësohen të trija kushtet e Nenit 11.3:
1. Të jetë informacion i dorëzuar nga operatori ekonomik sipas kërkesave të tenderit;
2. Operatori ekonomik të ketë bërë kërkesë me shkrim që ai informacion të mbahet sekret;
3. Operatori duhet të deklarojë se informacioni nuk është pronë publike, se e mbron nga zbulimi dhe të japë arsye konkrete që dëshmojnë se publikimi do t'i shkaktonte dëm material interesave të tij legjitime komerciale.

Madje, Neni 11.4 parasheh që nëse një dokument përmban edhe pjesë sekrete edhe pjesë jo-sekrete, AK duhet të përgatisë një version të pastruar, duke hequr vetëm pjesët e sekretit afarist — jo ta fshehë tërë dokumentin.

Edhe Rregullorja Nr. 001/2022, Neni 7.5–7.7, e konkretizon se zakonisht mund të klasifikohen si sekret informatat lidhur me kapacitetet ekonomike/financiare dhe teknike/profesionale, por OE duhet t'i identifikojë dokumentet dhe të plotësojë Aneksin 3 – Kërkesa për sekret afarist, me arsyetimin për secilin dokument.

Pretendimi NR.3 – Lista e Stafit

Mospërputhje në Listën e Stafit

Sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit, OE është obliguar të dorëzojë listën e stafit me emër, mbiemër, të dhëna personale dhe eksperiencën e punës.

OE "TONI O.P.", në listën e dorëzuar me ofertë, ka paraqitur Albin Bytyqi (nr. 5) dhe Arjan Bytyqi (nr. 6) si dy persona të ndryshëm, mirëpo të dy janë evidentuar me numër personal identik 1247864772. Rrjedhimisht, së paku për njërin prej tyre, e dhëna personale e kërkuar nga DT nuk është paraqitur saktë.

Sipas interpretimit nr. 12 të KRPP-së, datë 09.06.2023, Lista e Stafit përbën dëshmi të kriterit të kapacitetit teknik/profesional sipas nenit 69 të LPP-së. KRPP ka sqaruar se, kur ndryshimi apo zëvendësimi i personelit pas afatit do ta kthente një tender të papërgjegjshëm në të përgjegjshëm, kjo përbën ndryshim material, duke theksuar shprehimisht: "Kjo definitivisht nuk lejohet." Interpretimi i KRPP-së, pika 12[OBJ]

Të njëjtin parim e mbështet edhe Vendimi i OSHP-së nr. 2023/0328, ku ndryshimi i listës së stafit përmes paraqitjes së personelit pas ofertimit është trajtuar si ndryshim material, në kundërshtim me nenin 59.2 të LPP-së. Vendimi OSHP nr. 2023/0328[OBJ]

Për rrjedhojë, kërkojmë që AK ta rivlerësojë ofertën bazuar në Listën e Stafit të dorëzuar brenda afatit dhe të mos lejojë korrigjim apo zëvendësim që do të ndryshonte materialisht të dhënat/personelin e deklaruar. Nëse nga dokumentacioni fillestar nuk dëshmohet përmbushja e kërkesës së DT-së, oferta duhet të trajtohet si e papërgjegjshme në pajtim me LPP-në.

Pretendimi NR.4 – Gabimi ne Paramase

Pretendimi ankimor – Mospërputhje në kalkulimin e pozicioneve të paramasës

Autoriteti Kontraktues, gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertës së Operatorit Ekonomik të rekomanduar, nuk ka trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë mospërputhjet evidente në kalkulimin e pozicioneve të paramasës, ndonëse këto mospërputhje rezultojnë drejtpërdrejt nga vetë oferta financiare e dorëzuar.

Në paramasën e OE-së së rekomanduar, për disa pozicione është përcaktuar shprehimisht

baza mbi të cilën duhet të aplikohet përqindja përkatëse. Mirëpo, nga kontrolli matematikor rezulton se OE nuk e ka aplikuar përqindjen mbi të gjithë bazën e kërkuar nga pozicioni, duke krijuar kështu mospërputhje ndërmjet përshkrimit të pozicionit dhe vlerës së ofertuar.

Konkretisht:
Pozicioni

Kalkulimi që kërkon paramasa

Vlera në ofertë

Vlera sipas formulës

Diferenca

3.1.14

10% × (1,450.00 + 435.00)

145.00 €

188.50 €

43.50 €

3.4.4

10% × (135.00 + 54.00)

13.50 €

18.90 €

5.40 €

3.5.7

10% × (2,325.00 + 697.50)

232.50 €

302.25 €

69.75 €

Gjithsej

118.65 €

Veçanërisht evident është pozicioni 3.5.7. Sipas përshkrimit të paramasës, vlera e këtij pozicioni duhet të llogaritet në masën 10% mbi shumën e pozicioneve 3.5.5 dhe 3.5.6.

Pozicioni 3.5.5 është 2,325.00 €, ndërsa pozicioni 3.5.6 është 697.50 €. Rrjedhimisht:

(2,325.00 € + 697.50 €) × 10% = 302.25 €

OE ka ofertuar vetëm 232.50 €.

Madje, shuma prej 232.50 € nuk është rezultat i rastësishëm. Ajo përkon saktësisht me:

2,325.00 € × 10% = 232.50 €

Kjo dëshmon matematikisht se gjatë kalkulimit është përfshirë vetëm pozicioni 3.5.5, ndërsa është lënë jashtë pozicioni 3.5.6, përkundër faktit se vetë paramasa kërkon që baza të përbëhet nga të dy pozicionet.

E njëjta metodë e gabuar paraqitet edhe në pozicionet 3.1.14 dhe 3.4.4, prandaj nuk kemi vetëm një mospërputhje të izoluar.

Shkelja e nenit 59 të LPP-së

Sipas nenit 59 paragrafi 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, Autoriteti Kontraktues duhet t'i korrigjojë gabimet tërësisht aritmetike të zbuluara në tender, ndërsa korrigjimi nuk mund të tejkalojë kufirin ligjor prej dy për qind (2%) të vlerës totale të ofertës. Dispozita gjithashtu përcakton rregullin për trajtimin e mospërputhjeve ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total.

Rrjedhimisht, AK nuk ka mundur thjesht t'i anashkalojë këto mospërputhje. Ka pasur detyrim që gjatë ekzaminimit të ofertës t'i identifikojë, t'i kalkulojë dhe t'i trajtojë në përputhje me nenin 59 të LPP-së.

Nëse AK konsideron se bëhet fjalë për gabime tërësisht aritmetike, atëherë duhet të dokumentojë korrigjimin konkret dhe efektin e tij në vlerën totale të ofertës, përfshirë verifikimin e kufirit ligjor prej 2%.

Në të kundërtën, nëse korrigjimi i këtyre pozicioneve kërkon ndryshimin e një elementi të ofertës i cili sipas LPP-së nuk mund të ndryshohet pas hapjes së tenderëve, atëherë AK nuk mund ta rehabilitojë ofertën përmes një ndërhyrjeje të palejuar në përmbajtjen financiare të saj.

Pra, në të dy situatat AK duhet të japë trajtim dhe arsyetim juridik; mospërputhja nuk mund të lihet pa u shqyrtuar.

Praktika e OSHP-së – Vendimi 2026/0069

Në këtë aspekt është relevante edhe praktika e OSHP-së, përfshirë Vendimin nr. 2026/0069, në aktivitetin e prokurimit për "Ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Emergjente në QKUK".

Rëndësia e këtij vendimi qëndron në dallimin ndërmjet një korrigjimi të lejuar aritmetik dhe një ndërhyrjeje që në substancë do të ndryshonte çmimin për njësi të ofertuar nga OE.

Pikërisht ky test duhet të zbatohet edhe në rastin konkret: AK duhet të përcaktojë nëse vlerat e gabuara në pozicionet 3.1.14, 3.4.4 dhe 3.5.7 mund të korrigjohen vetëm përmes një operacioni tërësisht aritmetik sipas të dhënave ekzistuese të ofertës, apo nëse korrigjimi do të kërkonte ndryshimin e një elementi të ofertuar pas afatit për dorëzimin e tenderëve.

Nuk është e pranueshme që ky test të mos bëhet fare dhe oferta të konsiderohet e rregullt pavarësisht mospërputhjeve të dukshme matematikore.

Trajtimi i barabartë dhe objektiv i ofertave

Mosidentifikimi apo moskorrigjimi i këtyre mospërputhjeve prek edhe parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, pasi secila ofertë duhet t'i nënshtrohet të njëjtit

standard të ekzaminimit dhe vlerësimit.

AK nuk mund të tolerojë te një OE një devijim nga formula e përcaktuar në paramasë, ndërkohë që operatorëve të tjerë u kërkohet respektimi i plotë i dokumentacionit të tenderit.

Në veçanti, formula e përcaktuar nga vetë AK në paramasë nuk mund të konsiderohet fakultative. Nëse pozicioni kërkon 10% të shumës së dy pozicioneve paraprake, OE nuk mund të llogarisë 10% vetëm mbi njërin prej tyre dhe rezultati të trajtohet sikur është në përputhje të plotë me kërkesën.

Kërkesa

Për arsyet e paraqitura më sipër, kërkojmë që ky pretendim ankimor të aprovohet si i bazuar dhe të konstatohet se ekzaminimi dhe vlerësimi i ofertës së OE-së së rekomanduar nuk është kryer në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenin 59 të LPP-së.

Kërkojmë që vendimi i kontestuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim, me obligim që AK t'i shqyrtojë konkretisht pozicionet 3.1.14, 3.4.4 dhe 3.5.7, të përcaktojë natyrën juridike të mospërputhjeve, të bëjë kalkulimin e saktë të tyre dhe të zbatojë pasojat që parashihen nga LPP-ja.

Nëse korrigjimi konsiderohet gabim tërësisht aritmetik, AK duhet të veprojë sipas procedurës dhe kufirit të përcaktuar në nenin 59(3) të LPP-së. Nëse, ndërkaq, korrigjimi do të kërkonte ndryshimin e çmimeve apo elementeve materiale të ofertës pas hapjes, oferta nuk mund të bëhet e përgjegjshme përmes një ndryshimi të tillë.

Si prova materiale propozojmë që të administrohen faqet e paramasës së OE-së së rekomanduar ku gjenden pozicionet 3.1.14, 3.4.4 dhe 3.5.7, të paraqitura edhe në fotografitë bashkëngjitur, si dhe Vendimi i OSHP-së nr. 2026/0069 dhe dispozitat relevante të LPP-së.
Me poshte po bashkangjesim foton e kalkulmit :

GABIM NË LLOGARITJEN E PËRQINDJES – POZICIONI 3.1.14

Nr.	Përshkrimi i punës	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi	Shuma
3.1.12	Furnizimi dhe montimi i gypave të çelikut sipas standardit DIN 2448	m	50	20,00 €	1 000,00 €
3.1.13	Fitingjet për gypat e çelikut, si kthesa, reduktues, etj., janë 30% nga pozicioni i gypave 3.1.12	%	0,30	1 450,00 €	435,00 €
3.1.14	Materialet shpenzuese, si oksigjeni, acetileni, elektrodat për saldimin e gypave të çelikut, mbajtëset, gazi, teli për saldim dhe mbajtëset për gypa të çelikut nga pozicioni i gypave 3.1.12 dhe 3.1.13	%	0,10	1 450,00 €	145,00 €

SIPAS PËRSHKRIMIT TË POZICIONIT:
10% × (3.1.12 + 3.1.13) = 10% × (1 450,00 + 435,00) = 10% × 1 885,00 € = 188,50 €

NË OFERTË ËSHTË VENDOSUR: 145,00 €

DIFERENCA: 43,50 €

GABIM NË LLOGARITJEN E PËRQINDJES – POZICIONI 3.4.4

Nr.	Përshkrimi i punës	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi	Shuma
3.4.2	Furnizimi dhe instalimi i kanaleve të ajrimit prej llamarinë të zinkuar ...	kg	30	4,50 €	135,00 €
3.4.3	Furnizimi dhe instalimi i pjesëve fazonike të sistemit të ventilimit ... 40% nga pozicioni 3.4.2	%	0,40	135,00 €	54,00 €
3.4.4	Materiali shpenzues për lidhjen e kanaleve dhe pjesëve fazonike, ... do të përllogaritet në masën 10% të pozicioneve 3.4.2 dhe 3.4.3	%	0,10	135,00 €	13,50 €

SIPAS PËRSHKRIMIT TË POZICIONIT:
10% × (3.4.2 + 3.4.3) = 10% × (135,00 + 54,00) = 10% × 189,00 € = 18,90 €

NË OFERTË ËSHTË VENDOSUR: 13,50 €

DIFERENCA: 5,40 €

GABIM NË LLOGARITJEN E PËRQINDJES – POZICIONI 3.5.7

Nr.	Përshkrimi i punës	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi		Shuma
3.5.5	Furnizimi dhe montimi i gypave të bakrit					
3.5.5.1	Ø6.35 mm	m	30	8,00 €	240,00 €	TOTALI 3.5.5 = 2 325,00 €
3.5.5.2	Ø9.59 mm	m	80	12,00 €	960,00 €	
3.5.5.3	Ø12.7 mm	m	10	15,00 €	150,00 €	
3.5.5.4	Ø15.5 mm	m	25	18,00 €	450,00 €	
3.5.5.5	Ø22.2 mm	m	25	21,00 €	525,00 €	
3.5.6	Furnizimi dhe montimi i fitingu te gypave të bakrit ... 30% nga pozicioni 3.5.5	%	0,3	2 325,00 €	697,50 €	3.5.6 = 697,50 €
3.5.7	Materialet shpenzuese për saldim, si elektrodat, gazi argon për saldim, boroxi etj., do të merren në masën 10% të pozicioneve 3.5.5 dhe 3.5.6	%	0,1	2 325,00 €		232,50 €

SIPAS PËRSHKRIMIT TË POZICIONIT:
10% × (3.5.5 + 3.5.6) = 10% × (2 325,00 + 697,50) = 10% × 3 022,50 € = 302,25 €

NË OFERTË ËSHTË VENDOSUR: 232,50 €

DIFERENCA: 69,75 €

TOTALI I DALLIMIT TË IDENTIFIKUAR: 43,50 € + 5,40 € + 69,75 € = 118,65 €

Pretendimi NR.5 - Mosrespektimi i Kriterit nr. 7

Në lidhje me procedurën e prokurimit në fjalë, kërkojmë rishqyrtimin e vendimit për shpalljen fitues të Operatorit Ekonomik TONI O.P., për shkak të dyshimit të bazuar se nuk është respektuar Kriteri nr. 7 i përcaktuar nga vetë Autoriteti Kontraktues në dokumentacionin e tenderit.

Kriteri nr. 7 përcakton:

"O.E. duhet të sigurojë nuk ka më shumë se tri kontrata aktive me MKRS-në të natyrës së njëjtë, respektivisht në planin dinamik të punës nuk mund të jetë i njëjti arkitekt i licencuar ose mjeshtër i licencuar i angazhuar në më shumë se tri kontrata tjera të natyrës së njëjtë."

Sipas informatave dhe dokumentacionit që disponojmë, OE TONI O.P. rezulton i angazhuar në më shumë se tri kontrata/projekte të natyrës së njëjtë, ndër të tjera:

1. Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit – Lot II, nr. i prokurimit 207-25-9871-5-1-1, me vlerë 419,714.80 €;
2. Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit – Lot I, Shkolla e mesme Ryzhdije në Prizren, nr. 207-25-9810-5-1-1, me vlerë

623,717.70 €;
3. Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit – Lot II, Shkolla e vjetër e fshatit Mushnikovë, nr. 207-25-9810-5-1-1, me vlerë 271,326.50 €;
4. Shtëpia e Musli Hoxhës – Prishtinë;
5. Xhamia e Çokut – Junik.

Për më tepër, sipas dokumentacionit që disponojmë, në këto angazhime figuron i njëjti staf profesional, përkatësisht arkitekt/mjeshtër i licencuar, çështje e cila duhet të verifikohet nga Autoriteti Kontraktues në raport me planet dinamike të punës, kontratat aktive dhe periudhat konkrete të angazhimit.

Nëse këto kontrata kanë qenë aktive në të njëjtën periudhë dhe i njëjti arkitekt/mjeshtër i licencuar është paraqitur i angazhuar në më shumë se tri kontrata të natyrës së njëjtë, atëherë konsiderojmë se oferta e OE-së nuk përmbush kërkesën shprehimore të Kriterit nr. 7.

Autoriteti Kontraktues nuk mund ta përcaktojë një kriter si kusht të tenderit dhe më pas, gjatë vlerësimit, të mos e zbatojë atë në mënyrë të njëjtë ndaj operatorëve ekonomikë. Prandaj kërkojmë që të verifikohen zyrtarisht, pranë MKRS-së dhe autoriteteve/institucioneve përkatëse, statusi i secilës prej kontratave të lartcekura, datat e fillimit dhe përfundimit, planet dinamike të punës dhe emrat e stafit profesional të angazhuar.

IV. KËRKESA NDAJ ORGANIT SHQYRTUES TE PROKURIMIT

Duke marrë parasysh faktet, pretendimet dhe provat që do të paraqiten në vijim dhe duke u bazuar në dispozitat e lartcekura të LPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik, IDEAL PARTNERS SH.P.K. kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta aprovojë këtë Ankesë si të bazuar, të shqyrtojë individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar secilin pretendim dhe secilën provë të paraqitur, si dhe të verifikojë përsëri përputhshmërinë e tenderit të operatorit ekonomik të rekomanduar me të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Në rast se nga ky rishqyrtim konstatohen mospërputhjet e pretenduara, kërkojmë që Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të anulohet dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim, duke u siguruar që të gjithë operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kritereve dhe standardeve të njëjta dhe në pajtim të plotë me LPP-në, Rregulloren për Prokurimin Publik dhe Dosjen e Tenderit.

Po ashtu, në përputhje me Nenin 108/A të LPP-së, kërkojmë respektimin e efektit pezullues të kërkesës për rishqyrtim dhe ndërmarrjen e të gjitha veprimeve procedurale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

I propozojmë Organit Shqyrtues te Prokurimit (OSHP) :

I. Ankesen e paraqitur nga IDEAL PARTNERS SHPK / t'a vlerësoi **si të BAZUAR.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nuk kemi pretendime në këtë fazë

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*